



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.26, datë 20/09/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE “KËRKESË PËR LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJITJE”,
SHOQËRISË “MTSC” SH.P.K. ME VENDNDODHJE, BASHKIA
TIRANË**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujitje në rastin kur përdorimi është për ≤ 5 ha, ≤ 5 l/sek”, shoqërisë “MTSC” sh.p.k., me vendndodhje, “Ish-ndërmarja Metalike”, Bashkia Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e pus-shpimit

- X= 482775
- Y= 4576850
- Z= 95 m.m.n.d

Vendndodhja e pikës ku do të shfrytëzohet uji

- X= 482772
- Y= 4576861
- Z= 95 m.m.n.d
- Sasia e ujit në përdorim: 1 l/sek
- Sipërfaqja e parcelës, që do të ujitet: 0.04 ha
- Periudha e përdorimit: Nga muaj Prill në muajn Shtator (6 muaj)

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

